



Pranuar / Dorezuar Prilimeno / Predato Received / Delivered	09.07.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Pisfaq Appendix	Sasia Kolicitma Quantity
SKIMSHK	3896/2022		114

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.467/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.467/2022 të datës 19.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë Stacioni Policor Gjilan, kundër Vendimit me numër KDNSHC-05/013/2022 të Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 04.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.467/2022 e datës 19.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KDNSHC-05/013/2022 i datës 29.03.2022, i Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës.

Arsyetim

Ndaj ankuesit i sistemuar në vendin e punës “Shef Sektori” ne Stacionin Policor Gjilan-Drejtoria Rajonale e Gjilanit, me datë 22.03.2022 Kryesuesi i Komisionit Disiplinor ka iniciuar lëndën disiplinore me numër KDNSHC-05/09/2022 ndaj ankuesit me arsyetim se gjatë shqyrtimit të lëndës disiplinore KDNSHC-05/06/2022 ka gjetur shkelje disiplinore bazuar në ligjin e zyrtarëve publike të bërë nga ana e ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Policisë së Kosovës me datë 29.03.2022 ka marrë vendimin me numër KDNSHC-05/013/2022 me të cilin vendim ankuesit i shqiptohet masa disiplinore “Ndalesë prej 20% të pagës mujore bruto për tre (3) muaj”, të paraparë me Ligjin për Zyrtarët Publik Nr.06/L-

114 neni 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të cilin vendim ankuesi e ka pranuar me datë 21.04.2022.

Ankuesi [] i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës, me datë 19.05.2022 parashtron ankesë me numër protokollit 2916/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 27.05.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Policia e Kosovës. Këshilli më datë 07.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 19.05.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Urdhëresa e datës 26.04.2022; Urdhër i datës 21.02.2020; Ndërprerje e suspendimit të përkohshëm e datës 15.04.2020; Vendimi i datës 18.02.2020; Vendimi i datës 29.03.2022 i Komisionit Disiplinor; Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 17.03.2022; Vendimi mbi korrigjim i datës 29.03.2022; Kontrata e punës e [] Urdhëresa e datës 01.11.2010; Vendim i datës 08.09.2010; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 10.02.2022; Formulari i paraqitjes të disiplinës së brendshme; Vendimi i datës 31.12.2021 për ndalës të mëditjeve; e-mail i datës 28.01.2022, 12.01.2022, 07.02.2022, 09.07.2022, 26.12.2021, 25.12.2021, 22.03.2021, 02.03.2021, 18.02.2021; Kontrata e punës e ankuesit [] Përshkrimi i detyrave të vendit të punës të ankuesit; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 22.03.2022; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 29.03.2022; Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe provat shtese të ankuesit të datës 02.06.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [] është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit se është i pa kënaqur me vendimin me numër KDNSHC-05/013/2022 të datës 29.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe kërkon nga Këshilli që ti aprovohet ankesa e tij si e bazuar. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse në bazë të provave të lëndës është konstatuar se inicimi i lëndës disiplinore KDNSHC-05/09/2022 është bërë nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë ku është përcaktuar se: **"4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.3. me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore"**, sepse gjatë shqyrtimit të lëndës disiplinore Nr.KDNSHC-05/06/2022 ka gjetur shkeljet disiplinore të kryera nga ana e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vërtetuar se Komisioni Disiplinor me rastin e marrjes së vendimit me numër KDNSHC-05/013/2022 të datës 29.03.2022 për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit "Ndalesë prej 20% të pagës mujore bruto për tre (3) muaj", ka arritur që të konstatoj drejt gjendjen faktike dhe juridike sepse ka arritur që të vërtetoi se ankuesi [] ka marrë tri (3) vendime atë të datës 05.01.2022, 30.12.2021 dhe 30.11.2021 për ndalës të pagës të mëditjes ndaj nëpunësit [] e të cilat ndalesa/masa nuk janë kompetencë e ankuesit [] por ato masa mund ti shqiptoj vetëm Komisioni Disiplinor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Policisë së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KDNSHC-05/013/2022 të datës 29.03.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Me dispozitat të nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik si dhe nenit 11 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, janë përcaktuar kompetencat e Komisionit Disiplinor, si në vijim:

"1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca:

1.1. bene shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura;

1.2. përcakton dhe shqipton masën disiplinore".

Në pajtim me dispozita ligjore të lartë cekura, Komisioni Disiplinor ka mandat të dëgjoj dhe shqyrtoj provat në lidhje me shkeljen e supozuar po ashtu edhe në seancën e Komisionit Disiplinor ankuesi [] ka pranuar se e ka tejkalluar kompetencën e tij me vendimet e datave 05.01.2022, 30.12.2021 dhe 30.11.2021 për ndalës të pagës të mëditjes ndaj nëpunësit [] i cili e ka pranuar se fare nuk e ka konsultuar Ligjin e zyrtarëve publik.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Policisë së Kosovës në rastin e shqiptimit të masës disiplinore „Ndalese prej 20% të pagës mujore bruto për tre (3) muaj”, me arsyetimin që nëpunësi [] ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 50 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se **1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit" dhe 2. "Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer"**, sepse janë shqyrtuar të gjitha provat dhe faktet duke vlerësuar edhe rrethanat rendues dhe lehtësuese, si dhe rrethanat e tjera pasi që ankuesi në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka marrë tri vendime ndalesë në page të cilat dënime sipas ligjit nuk janë kompetence e tij sepse vendimet për ndalesë në pagë paraqesin shkelje të rende disiplinore dhe një vendim të tillë mund ta marr vetëm komisioni disiplinor, dhe këtë rast masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor është në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se „ **Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj"**, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marre parasysh faktet e lartcekura ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KDNSHC-05/013/2022 të datës 29.03.2022 ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën Administrative si dhe të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetares së Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.467/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Policisë së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.